



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 13467 Prot

Lezhë, më 29/07 /2022

VENDIM

Nr. 83, Datë 28.07.2022

PËR

“NJË SHITESË NË VKB-NË NR. 5, DATË 28.01.2020 “PËR MIRATIMIN E SISTEMEMEVE
TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMET SOCIALE TË STREHIMIT”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr 22/2018 “Për Strehimin Social”, neni 15 pika 3, VKM nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij” pika 2 dhe 2.1, VKM nr. 384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore” pika 12, VKM nr.453 datë 03.07.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti” pika 13, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë nr. 5, datë 28.01.2020 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programet sociale të strehimit”, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1. Miratimin e një shtesë në pikën I/1 të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë nr. 5 datë 28.01.2020 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programet sociale të strehimit”, duke u shtuar pika 3 me përmbajtje si më poshtë:
 - Në rastet kur në listën e familjeve përfituese kemi më shumë se një familje me pikë të barabarta, përzgjedhja e aplikantëve përfitues do të bëhet nëpërmjet shortit të organizuar nga Komisioni i Strehimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ



KRYETARI
INDUE LULI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

kesh

Nr. 13467/1 prot
08.08.2022

**PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN**

Nr. 549/9 Prot.

Lezhë, më 04.08.2022

Lënda : Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHE

Lezhë

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHE

Lezhë

Bazuar në ligjin Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pika 2 gërma “b”, në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, neni 13, pika 2, neni 15, neni 16, neni 24, pika 2, neni 54, gërma “k”, neni 55, pika 2 dhe 6, në ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, neni 15, neni 16, neni 47, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 453, datë 03.07.2019 “Për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit, për të përfituar strehim sipas çdo program social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, **konfirmoj bazueshmërinë ligjore** të vendimit nr. 83 datë 28.07.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Një shtesë në VKB-në nr.5, datë 28.01.2020 “Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet sociale të strehimit”.

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

